



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 37, datë 23.07.2025

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.63, DATË 17.03.2023, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.130, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar me Urdhërin nr.222, datë 06.07.2020, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Raportit me nr. 14508 Prot., datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 17.03.2023, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.130, rruga “Aleksandër Goga”, në Njësinë Administrative nr.4, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
23	VITO NAKUCI, MARJANTHI PRIFTI, PAULIN NAKUCI, ROZA TUSHI, EDLIRA NAKUCI	1	1+1
24	ALFRED TUSHE	4	2+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK Durrës



Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.07.2025




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 511/4 prot.

Durrës, më 24.07.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.37 datë 23.07.2025, “Për miratimin e disa shtesave të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 17.03.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4, pallati nr.130, rruga “Aleksandër Goga”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

